



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 30 dhjetor 2020, në mbledhjen e XL (dyzetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe dy anëtarët e rinj z.Bahri Blakçori dhe z.Kasib Bashota të certifikuar nga KQZ, ndërsa munguan Endritë Murati dhe Blerim Maçastena i cili është ndaluar dhe është në mbajtje nga autoritetet Serbe (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal (rreth 15)

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje në këtë seancë e cila po mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Konstatoi kuorumin dhe shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë. Fillimisht dëshiroj t'ju rikujtoj se pas dhënies së dorëheqjes nga dy anëtarë të Kuvendit të komunës z.Avni Fetahu dhe z.Pajtim Balaj të cilët janë emëruar drejtor në Ekzekutivin e Komunës, unë si Kryesues i Kuvendit kam zhvilluar gjitha procedurat për zëvendësimin e të përmendurve. KQZ ka bërë zëvendësimin e anëtarëve të cekur, këtë e bazoj në dy vendimet e nxjerra më datë 21.12.2020 që kam këtu përpara sipas të cilëve; z.Avni Fetahu është zëvendësuar nga z.Bahri Blakçori, dhe z.Pajtim Balaj është zëvendësuar nga z.Kasib Bashota. Për të konstatuar këtë që e ceka, ftoj Komisionin për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit, të bëjë verifikimin e të përmendurve, dhe të dalin me një raport të shkurtër. Urdhëroni komisioni verifikues, mund të filloni me punë, (znj.Doruntina Hasani, z.Fatmir Rudari dhe një anëtar nga radhët e grupit të LDK-së i cili paraprakisht duhet të propozohet sepse siç jeni në dijeni në këtë komision ka qenë z.Avni Fetahu), urdhëroni propozojeni.

z.Hasan Ajeti shëf i grupit të këshilltarëve nga LDK theksoi, ne si grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së propozojmë z.Afrim Shabani si anëtarë të komisionit verifikues.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit theksoi, e hedhë në votim propozimin e z.Hasan Ajeti.

Njëzëri përkrahet zëvendësimi i anëtarit të ri z.Afrim Shabani në vend të ish anëtarit të komisionit verifikues z.Avni Fetahu.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani lus komisionin të verifikoj mandatin e dy anëtarëve të lartcekur.

znj.Doruntina Hasani, paraqiti raportin nga verifikimi i dy anëtarëve të cekur, theksoi, KQZ ka vendosur që në vend të ish anëtarit të Kuvendit z.Pajtim Balaj të zëvendësohet z.Kasib Bashota nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa në vend të ish anëtarit të kuvendit Komunal z.Avni Fetahu të zëvendësohet z.Bahri Blakçori, ne si komision ju urojmë punë të mbarë dhe suksese të dy anëtarëve të rinj të zgjedhur.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj Komisionin dhe konsideroj se tani jemi në rregull dhe mund të bëhet betimi solemn nga ana e anëtarëve të ri të Kuvendit.

Ju sqaroj se dhënia e betimit bëhet si në vijim;

Së pari ngritemi në këmbë unë dhe dy anëtarët e ri, unë e lexoj deklaratën e betimi kurse ju vetëm e përsëritni me zë atë që unë e lexoj, me të vetmin ndryshim që pas fjalës unë, ju e përmendni emrin tuaj.

Me tekstin si në vijim, bëhet betimi i dy anëtarëve të lartcekur:

“Unë (duke theksuar emrin dhe mbiemrin secili nga anëtarët), betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e tani e tutje jeni anëtarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë. Ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese. Para se të kalojmë me punë, ju rikujtoj që në një afat sa më të shkurtër, të bëni deklarinimin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion.

z.Bahri Blakçori, theksoi, i nderuari Kryesues dhe i nderuari Kryetar, drejtor, koleg/e, dhe ju të pranishëm, të dashur qytetarë të Komunës së Podujevës, falënderoj të gjithë përkrahësit dhe mbështetësit për gjatë aktivitetit tim politik, rrugëtimi im politik nga sot do të vazhdojë me Lëvizjen Vetëvendosje. Jam i bindur që me Kryetar z.Shpejtim Bulliqi dhe me Lëvizjen Vetëvendosje do të punohet më mirë dhe më shumë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, të nderuar të pranishëm pak ditë më parë humbëm një çlirimtar, një pjesëtar apo oficer të lartë të ushtrisë së Kosovës (FSK-së) meqenëse ai ishte xhaxhai i anëtares së Kuvendit znj.Endritë Murati dhe që familjare/hallë e ka edhe femrën e parë të gueriles të vitit 1989, kërkoj që në nderim të veprës së tij të mbajmë një minutë heshtje.

Mbahet një minutë heshtje në nderim të të ndjerit (Gyner Murati).

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lavdi veprës dhe kontributit të tij.

z.Vendenis Lahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së dëshiroj të propozoj si pikë për rend të ditës pikën e informatës së Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për vitin financiar 2020. Kjo pikë është dërguar nga Ekzekutivi i Komunës në KPF, mirëpo në KPF nuk u rekomandua për shqyrtim në Kuvendin Komunal, andaj unë dëshiroj që ta vë në votim këtë pikë që të futet si pikë e rendit të ditës për shkak se në atë informatë janë shumë informacione të nevojshme për të gjithë ne asamblastët pa dallime partiake. Dëshiroj të theksoi se gjatë këtyre tri viteve në asamble komunale ne jemi përballur me mungesë informatash të pa mjaftueshme, të gjithë asamblastët nga të gjitha subjektet politike pa përjashtuar edhe ata nga radhët e LDK-së, nuk kanë pasë informata të mjaftueshme për punën e Ekzekutivit sepse qasja në to nuk ka qenë asnjëherë e lehtë dhe shpeshherë Ekzekutivi ka refuzuar të përgjigjet. Kjo pikë është sjellë dje në KPF për shkak se koha e pagesave

dhe punëve tjera rrjedhëse përfundojnë me datë 26.12.2020, certifikimi i pagesave dhe për datën 28 apo 29.12.2020, ka qenë i gatshëm, ndoshta dikush mund të thotë se kjo informatë është me vonesë por unë mendoj se nuk është me vonesë sepse kjo është informatë, dhe duke qenë e tillë besoj se është e nevojshme ta dëgjojmë dhe ta kemi të gjithë ne.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, njoftoj të pranishmit se në këtë mbledhje mungojnë dy këshilltarë/e të kuvendit, znj.Endrita Murati dhe z.Blerim Maçastena, ndërsa 33 këshilltar janë prezent për çka kushtet për punë dhe vendimmarrje janë plotësuar.

Para se të fillojmë me procesin, konsideroj se materialin dhe rendin e ditës e keni marrë me kohë, para vetës keni konstatimet dhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së, dhe keni mund të vëreni rendin e ditës të konstatuar dhe rekomanduar për këtë mbledhje të Kuvendit, përkatësisht që pika e parë apo informata në fjalë që parafolësi nga radhët e LVV-së e përsëriti qëndrimin e KPF-së, pra ju informoj se nga shumica e anëtarëve të KPF-së është konstatuar që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës me arsyetimin se materiali përcjellës ka ardhë me vonesë, dje dhe është shpërndarë te anëtarët e KPF-së. Gjithashtu është konstatuar se propozimet e Ekzekutivit të Komunës të cilat janë sjellë të futen në propozim planin e punës së Kuvendit të cilin e kanë përgatitur Grupi punues i përbërë nga anëtarët e Kuvendit nga katër subjekte politike e që me një ujdi të plotë është miratuar, madje me përfshirjen më të madhe dhe kontributin e këshilltarit nga radhët e LVV-së z.Fitim Muçolli, e kemi miratuar të plotë atë propozim draft të punës së Kuvendit për vitin 2021.

Gjithherë plani i punës mbetet që të pasurohet me të gjitha ato tema dhe pika që janë të rëndësishme për qytetarët, Kryetarin, Ekzekutivin dhe Kuvendin e Komunës. Çdo iniciativë apo qdo pikë e rendit të ditës që sjellët është e mirëseardhur dhe ne bashkërisht me Kryetarin e Komunës do të koordinohemi dhe do të pasurojmë këtë plan të punës, prandaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë e hedh në votim rendin e ditës duke përfshirë edhe konstatimet dhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, më vie mirë që prezent këtu me ne është Kryetari i Komunës, sa i përket pikës së rendit të ditës që e propozoi kolegu z.Vendenis Lahu, kemi diskutuar edhe dje në KPF rreth futjes së pikës në fjalë, n'kuadër të rendit të ditës. Sa i përket Grupit të këshilltarëve të PDK-së, edhe në të kaluarën por edhe në të ardhmen do të jemi kritik, madje së bashku me LVV-në si opozitë kemi qenë kritik që materialet mos të sjellën kur fillon mbledhja për arsye se duhet me u përgatit për material e jo vetëm me dalë në foltore dhe me fol qoftë edhe për buxhetin e kaluar, dhe mos të flas vetëm ai që ka qasje aty, shembull, për financat drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, qoftë ai që ka qenë apo ky i tanishmi.

Absolutisht e kemi monitoruar buxhetin aktual të përmbyllur më datë 30.12.2020, të gjitha Grupet e këshilltarëve në Kuvend kemi fol dhe debatuar por nuk na kanë dëgjuar askush, tani dhe dje unë kam thënë se kam menduar që ndryshimi kur të vij do të vij edhe ndryshimi qeverisës me këdo që vije dhe tani Lëvizja Vetëvendosje ka ardhë në pushtet, mirëpo rrugëtimi është i njëjtë për arsye se materialet sillen njësoj, ne kemi kërkuar që mbledhja e KPF-së të mbahet tri ditë më herët në mënyrë që Grupet e këshilltarëve të asamblesë komunale të koordinohen mes veti apo edhe brenda Grupit, për ndonjë votim i cili do të i jepte mbështetje qeverisjes. Ne do të votojmë propozim vendime që sjellën me kohë dhe që janë të arsyeshme, nga Kryetari apo drejtorët e Drejtorive përkatëse, por do të jemi kundër kur janë jashtë procedurës për arsye se dëshirojmë të respektohet rendi.

Informata që e ceku z.Vendenis Lahu sillet kur ndonjëri prej këshilltarëve kërkon informatë prej Drejtorisë përkatëse, unë edhe dje kam thënë se nëse dëshironi për informim edhe si subjekt politik apo edhe si zyre e informimit e Kryetarit, të paraqitni në tërësi gjendjen se çka ka ndodhë, jo përmes rrugëtimit që ka ardhë dje në KPF, mos me vazhdu me këtë rend dite, por mos me futë në rend dite këtë pikë sepse rendi i ditës ka qenë. I nderuar Kryesues tani unë mendoj se duhet me qenë një

bashkëpunim më i ngushtë mes Kryesuesit dhe Kryetarit kur kërkohet vota e dikujt për mbështetje sepse Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së i takon që të gjitha ato që i ka kërkuar si Grup ku qeverisja e kaluar nuk i ka respektuar asnjëherë, duhet ti zbatoj tani dhe të merret edhe mbështetja nga ne, me keqardhje po e them, por kjo është edhe ajo që dje e deklarova se nuk votoj asnjë material i cili vjen direkt në mbledhje, me letër. Jemi dëshmitarë të gjithë ne se materiale dhe pika të tilla nuk i kam mbështetur dhe votuar as LDK-së, madje nuk do e votoja as nëse do të ishte subjekti që i takoj unë. Pra Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së nuk i voton pikat që kanë ardhë në mbledhje direkt sepse nuk i kemi votuar asnjëherë.

z.Vendenis Lahu, theksoi, dëshiroj të jap një sqarim, propozimi nuk debatohet vetëm nëse del në Kuvend, është e vërtetë ajo që ka deklaruar z.Rafet Llapashtica, edhe unë në mbledhjen e kaluar i kam thënë z.Rafet Llapashticës që Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së ka kërkuar disa herë prej Drejtorive dhe Ekzekutivit të kaluar që të sjellin informata përkatëse.

Lëvizja Vetëvendosje në të kaluarën i'u ka thënë pse po e sjellni një ditë më herët informatën por le të kuptohemi që informata as nuk votohet mirëpo merret si e tillë dhe përpunohet që të informohemi. Këshilltarët e LVV-së kanë kërkuar disa herë në mbledhje të KPF-së informatë nga DKA dhe DSHMS, mbledhje të cilat janë mbajtur vetëm një ditë më herët para mbajtjes së seancës kështu që nuk ka kurrfarë ndryshimi në qëndrim të LVV-së nga e kaluara dhe tani është e njëjta gjë.

Informata që është sjellë nuk është me vonesë për shkak se procedurat dhe raportet financiare mbyllën shumë vonë dhe kjo informatë në afatin sa më të hershëm të mundshëm është sjellë, dhe është vetëm informatë dhe nuk ka nevojë dikush të frikësohet informatës për punët të cilat i ka bërë Komuna, këtë nuk e kam të qartë përse. Sa i përket asaj që e ceku Kryesuesi, ajo nuk ka kaluar dje mirëpo ekipi ligjor i cili merr pjesë në ato mbledhje asnjëherë ne nuk na ka thënë se kjo nuk mund të futet si propozim, ne nuk jemi jurist mirëpo kemi ekipin ligjor që merret me këto çështje prandaj mendoj që kjo vetëm duhet të hidhet në votim dhe pastaj nëse kalon diskutohet dhe mund të debatohet nëse ka vullnet, mundemi edhe mos me debatue sepse kjo është informatë me të dhëna zyrtare të cilat janë sepse nuk mendoj që drejtori ka të drejtë të bëjë gjëra që janë të pa sakta.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit theksoi, sa për sqarimin e të gjithëve, për rend dite nuk ka debat, shkurt dhe qartë propozuesi propozon, hidhet drejtë në votim.

Kjo situatë dje ka ardhë me konstatime dhe rekomandime nga mbledhja e KPF-së, andaj unë e vë në votim rendin e ditës sipas konstatimeve të rekomanduara nga KPF.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, *konstatoj se me 22 vota për, 1 votë kundër dhe 6 vota abstenim u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të KPF-së.*

1. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2021

z.Fevzi Jetullahu U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim-DSHPMSH dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, bazuar në obligimet ligjore që deri më datë 31.12.2020, Kuvendi Komunal të miratojë listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2021, i është dërguar propozim vendimi Kryetarit për të shqyrtuar dhe miratuar. Këto propozime janë nxjerrë në bazë të ligjit nr.06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe

këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, duke iu ofruar të dhëna të bashkëngjitura në propozim prandaj kërkoj që kjo listë të miratohet, sipas materialit përkatës të cilin besoj që e keni para vetës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, dëshiroj të paraqes qëndrimin e Grupit të këshilltarëve të nga radhët e LDK-së lidhur me këtë propozim vendimi për miratim e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Podujevës. Referuar materialit respektivisht bazës ligjore që thirret ky propozim e që është neni 13 i këtij ligji i cili rreth publikimit të listës së pronave të paluajtshme të Komunës, përcakton, po e citoj paragrafin 1 ku thuhet, *Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës së Podujevës.* Gjykojmë se ky propozim vendim vie jo i plotë siç e përcakton ligji por vjen te ne si i pjesshëm në arsyetim se do të ketë inpakt ekonomik për zhvillim të Komunës e që shumica e këtyre pronave janë kulloza dhe ara.

Gjatë tri viteve të fundit që Ekzekutivin e Komunës e ka udhëhequr LDK-ja, ka qenë kërkesë e përhershme e këshilltarëve komunal e në veçanti të Lëvizjes Vetëvendosje që të paraqiten të gjitha listat e pronave të uzurpuara, në qoftë se ka në Komunën e Podujevës e që si Ekzekutiv tani e keni shumë të lehtë pasi që e keni edhe pushtetin që deri dje jeni thirrur që nuk e keni, keni evidencën me të gjitha pronat e paluajtshme të Komunës që nënkupton pronën e paluajtshme të regjistruar në emër të Komunës në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme ashtu siç e parasheh ligji, ndoshta kjo është edhe arsyeja që ende nuk kemi drejtor të DPKGJ pasi që z.Fevzi Jetullahu është drejtor i DSHPMSH, pasi që vjen nga lokaliteti që vij edhe unë e uroj shumë të respektuar kolegë asamblist dhe qytetarë, por nesër ai ose cilido që të jetë drejtor do të jetë palë në procedurë kur të mbrojë interesin e Komunës në raport me Kryetarin z.Shpejtim Bulliqi si palë uzurpuese e pronës publike, do të jetë imazh jashtëzakonisht i rëndë për vetë Komunën ku zyrtari më i lartë administrativ i Komunës respektivisht Kryetari nesër është palë në procedurë gjyqësore, pa prejudikuar epilogun pasi që është kompetencë e sistemit të drejtësisë, për dallim me kualifikimin që ju kolegë asamblist të LVV-së keni bërë edhe në rastet kur ka pasë një raport të auditimit keni marrë kompetencë dhe keni goditur dhe kualifikuar me terma që jep vetëm sistemi i drejtësisë apo sistemi gjyqësor dhe atë për ne që vijmë nga fusha juridike e besoj që z.Bajram Ajeti e di shumë mirë prezumimin e pafajësisë deri në marrjen e vendimit të formës së prerë askush nuk ka të drejtë të drejtoj gishtin dhe të kualifikojë me ato terminologji që ju dini.

Ofrojeni komplet listën e pronave ashtu siç parashihet në dispozitat ligjore që ju vet jeni thirrur dhe atë që ju deri dje keni thënë se ka prona të uzurpuara, sigurisht ju keni edhe prova materiale që ka prona të uzurpuara pa asnjë dyshim do të keni edhe mbështetjen tonë si Grup i këshilltarëve të LDK-së. Unë personalisht mbajë përgjegjësi atë që e them para jush dhe nuk frikësohem se nesër ose pasnesër mund të dal ndonjë zyrtarë i LDK-së që ka uzurpuar pronë komunale, le të dalin cilido që të jetë, përgjegjësia është individuale nuk është kolektive, prandaj të nderuar të pranishëm dhe qytetarë të Komunës së Podujevës kjo është arsyeja që Grupi i këshilltarëve të LDK-së nuk e mbështet këtë propozim vendim.

z.Bajram Ajeti, theksoi, Kryetari i Komunës në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale për këtë seancë ka propozuar vendimin për miratim të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2021, brenda afatit ligjor që është në pajtim me nenin 13 të ligjit nr.06/L092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ku lista e pronave përmban edhe të gjitha të dhënat e kërkuara sipas paragrafit 2 të ligjit, të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit, njoftimin, dhe periudhën kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Duke pasë parasysh edhe Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në nenin 17 të kësaj Rregulloreje është përcaktuar se Kuvendi i Komunës formon komision vlerësues i cili ekziston por duhet të plotësohet me dy anëtar të tjerë nga Ekzekutivi i Komunës të cilët duhet të propozohen nga Kryetari i Komunës, për momentin komisionin nuk e kemi të kompletuar. Grupi i këshilltarëve të LVV-së do të votojë aprovimin e këtij propozim vendimi sepse është ligjor dhe përmban të gjitha elementet e kërkuara nga ligji dhe më vie keq se në emër gjoja të mos kompletimit të dal tani Grupi i këshilltarëve të LDK-së dhe të thotë se ne nuk ua aprovuam pa dhënë të dhënat apo sqarimet se cilat janë ato mangësi të këtij propozim vendimi. Sa i përket paragjytimeve që ishin edhe jashtë kësaj fushe për të cilën edhe ne po e trajtojmë sot mendoj që nuk janë të nevojshme, kështu që ne si Grup do ta përkrahim këtë propozim vendim sepse është çështje ligjore. Asnjëherë Grupi i këshilltarëve të LVV-së nuk ka pasë rast që nuk ka votuar propozim vendimet që kanë qenë të bazuara në ligj dhe obligime ligjore, këtë e dini edhe ju shumë mirë.

Tani dëshiroj t'iu drejtohem qytetarëve dhe juve të nderuar të pranishëm, shfrytëzoj rastin nga kjo foltore gjithë qytetarëve të Komunës sonë dhe gjithë qytetarëve të Kosovës e gjithë shqiptarëve në trojet e veta dhe mërgatës tonë të dashur e të mrekullueshme në emrin tim dhe të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, t'ua uroj nga zemra vitin e ri 2021 duke i'u uruar mbarësi shëndet dhe lumturi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket pikës për dhënien e pronave publike në shfrytëzim, në parim kemi qenë dhe jemi që prona publike të jepet në shfrytëzim mirëpo në vendim as ju LVV-ja e as LDK-ja nuk e keni zbatuar atë që e diskutuat për publikimin e pronës, megjithëse LVV ka filluar pak me dispozicion më të mirë sepse veç sa ka filluar qeverisjen dhe nuk po dua të lëshohem më tutje sepse dje unë kam kërkuar zyrtarisht që në proces me fut listën e pronave cilat janë dhënë me qira, cilat janë të lira për dhënie në shfrytëzim, cilat prona janë të uzurpuara dhe borxhet që kanë mbetur nga dhënia e pronave në shfrytëzim sepse janë të hyra vetanake, buxhet të cilin Komuna e mban sa të dëshirojë dhe mund ta shfrytëzoj si të dëshiroj. Këto të hyra nuk janë grant qeveritar qysh ka mbetë suficiti rreth 2,000,000.00€ vitin e kaluar, prandaj ne jemi një ndër Komunitatet e cila nuk ka mund ta subvencionojë asnjë qytetar që është i infektuar me covid-19. Komuna e Dragashit si një ndër Komunitatet më të vogla në vend ka ndarë shumën prej 500€ për ç' do qytetarë të prekur nga covid-19, kurse ne asgjë. Ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së mund të abstenojmë lidhur me këtë pikë, jo për arsye se këtë pikë e ka propozuar një subjekt tjetër apo për shkak se nuk e ka publikuar një subjekt tjetër që ka qenë më parë, por për arsye sepse asnjëri nga ne si asamblistë që jemi nuk e dimë statusin e këtyre pronave, dimë vetëm vend ndodhjen e këtyre pronave siç janë në fshatra Batllavë, Zakut, etj, por edhe në qytet por nuk e dimë gjendjen e tyre. Unë e di që ka prona që 20 vite që shfrytëzohen, por a shfrytëzohen këto prona me miratimin e LDK-së, apo po vazhdojnë me zyrtarizmin e LVV-së, nuk e di, po të ishte prezent drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë të na jap sqarime rreth këtyre parcelave, gjendja do ishte ndryshe sepse asnjë nga këshilltarët që janë prezent këtu nuk kanë njohuri se ku gjendet shembull, parcela me nr.4128, dhe të votoj pro atëherë jemi në rregull dhe vota ime do të jetë pro për këtë çështje.

Unë votoj (i drejtohet z.Avni Fetahut, drejtor i DKA-së) po të tregoj se ti nuk mund të më ndjekësh sepse ke qenë kryetar i Grupit të këshilltarëve të LDK-së kur ne PDK dhe LVV kemi "rreh tupana" si opozitë, madje je djersitë me pauza të seancave për të shikuar se çfarë të bëjë, prandaj mos më fut në atë rrugë sepse ke qenë drejtor i LDK-së, nuk ke sjellë plan të punës e as raport, ke qenë drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nga radhët e LDK-së, të kam thënë edhe një herë në këtë seancë po të them sërish e ke thirr qytetarin nga fshati Surdull që të marrë sistemin e ujitjes pikë pikë pa aplikuar fare, më fute në një fushë që nuk desha të përmend emra. Fjalën e mbaj

unë dhe jam deklaruar në këtë seancë dhe kur deklarohej edhe para mediave edhe para Ekzekutivit dhe para qytetarëve, deri në fund i qëndroj fjalës. Nuk dëshiroj asnjë debat të flas për parti, edhe pse përfaqësoj një subjekt politik sepse unë di ti them qoftë subjektit tim kur nuk është në rregull, edhe ty Avni kur je në pushtet por edhe kur je në opozitë edhe pse kur ke qenë opozitë paksa të kam kursyer por tani më detyrove ti them ato fjalë që nuk dola dhe nuk pata ndërmend t'i them.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, ky propozim që kemi sot para nesh është propozim për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, ne si Grup i këshilltarëve të AAK-së e mbështesim me arsyetimin se prona komunale në formë se si është trajtuar deri më tani ka qenë jo e duhur. Komuna obligativisht në bazë të rregullativës ligjore kujdeset dhe menaxhon pronën komunale por cila është gjendja e pronës komunale sot. Është fol shumë në këtë Kuvend dhe jashtë këtij Kuvendi lidhur me gjendjen e pronave, sa është numri i atyre pronave dhe cilat janë ato, në shfrytëzim të kujt janë ato sot, a inkason Komuna të hyra nga këto prona sa edhe si, andaj kur i kam këto parasysh unë mendoj se do të mbështetet ky propozim. Efektet e këtij propozimi i shohë në rend të parë ekonominë që do t'i kenë në shfrytëzim këto prona, gjegjësisht gjenerimin e vendeve të reja të punës, të hyra vetanake për buxhetin komunal dhe ana tjetër komuna tregon seriozitetin në trajtimin e pronës së vet, tregon se këto prona kanë Zot shtëpie, kanë titullarin e vet e ajo është komuna. Nga formulimi i këtij propozim vendimi kuptojmë se sot do ti trajtojmë vetëm disa prona të veçanta e unë mendoj që në një afat optimal ti trajtojmë të gjitha pronat komunale dhe mendoj se të gjitha ato prona me arsyetim të njëjtë dhe destinacionin në bazë të specifikave të pronave të jepen në shfrytëzim, gjegjësisht të jenë publike në ueb faqen e Komunës dhe kështu qytetarëve do ti krijohen mundësi, Komuna do ti rrit të hyrat vetanake dhe do të kujdeset për pronën e vet që e ka për obligim ligjor në bazë të ligjit për qeverisjen lokale. Për fund, këtë zotim për publikim të pronave komunale dhe gjendjen e tyre në ueb faqen komunale e kemi pasë zotim gjatë fushatave zgjedhore të kandidatëve për Kryetar Komune që nga viti 2013.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, falënderoj z.rafet Llapashticën i cili më japi mundësinë të bëjë replikë, gjithashtu pata ndërmend ta bëjë një sqarim të caktuar, për kureshtje e nxjerra procesverbalin e viti të kaluar, pikërisht në muajin dhjetor dhe pa dashur t'ju ngarkoj shumë fjalja është kështu *“pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se njëzëri u miratua propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020, sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së”*, e njëjta listë është tani, me përjashtim të dy pronave që janë kontestuese, edhe është e pasqyruar kjo listë me atë që e kërkoj z.Rafet Llapashtica, ku secila pronë me anë të google map është e precizuar dhe është më e avancuar ku të njëjtën e keni votuar, e që tani nuk po e votoni, andaj po ju pyes se apo ju vjen marre, sepse tjera pyetje nuk kam. Është e rëndësishme që këtë kërkesë tjuaj që kinse nuk është e plotësuar, e gjëra tjera rreth listës, po ua rikujtojmë qytetarëve se të njëjtën listë ju e keni votuar, po këtë të njëjtën e ka votuar edhe LVV-je, andaj lojëra të tilla ju vetëm në kafene mund t'i bëni.

z.Fatmir Rudari, theksoi, fjalimi i parafolësit z.Avni Fetahut më bëri të dalë në foltore, fjalim ky i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, do të thotë është një sjellje e pa hijshme për Kuvendin e Komunës, qëndrimet mund t'i ndërrojmë qoftë edhe brenda jave, nuk do të thotë se çfarë kemi bërë para një viti të bëjmë edhe sot. Para një viti t'i (i drejtohet z.Avni Fetahut) ndoshta nuk keni qenë në LVV-je, ndoshta po, por tani je dhe nuk i dihet se çfarë do bëjmë ne në të ardhmen, mirëpo sot ne jemi kundër këtij propozim vendimi.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, kërkoj nga ju sot që t'i lëmë anash aspektet politike dhe të kontribuoni të gjithë në miratimin e kësaj pike të rendit të ditës për faktin se kemi të bëjmë me një listë të veçantë të planifikuar për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të

Komunës, nuk jemi duke folur për gjitha pronat komunale si tërësi por jemi duke folur për një listë të veçantë për të cilën sipas informacioneve që kemi ne është përditësuar me disa prona të reja dhe e cila nuk ka asnjë ndryshim nga lista e cila është miratuar vitin e kaluar nga kjo përbërje e këtij Kuvendi të Komunës.

Arsyeja se ndryshimet ne i kemi dhënë dhe janë publike, kjo listë është listë e juaja përkatësisht e Ekzekutivit të kaluar, me disa ndryshime të cilat janë të emëtuara qartë dhe mirë çdo njëra prej tyre dhe mendoj se është mirë ta përkrahni, ndërsa se a do ta përkrahni apo jo sërish do të mbetet në çështjen tuaj si Grupe të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, Grupi i LVV-së sigurisht se do ta përkrah sepse ne këtu e shohim interesin e qytetarëve dhe unë besoj se ju të gjithë jeni të thirrur që ta mbronin këtë interes të qytetarëve, do t'i krijoni një mundësi në radhë të parë qytetarëve të Komunës së Podujevës, pastaj Ekzekutivit të Komunës së Podujevës që ndoshta ndonjëra prej investimeve në vitin 2021 mund të jetë pjesë integrale e mundësisë së shfrytëzimit të këtyre pronave përmes të cilave shfrytëzime Komuna e Podujevës do ketë mundësi të inaksimit të të hyrave, por para së gjithash do të ju mundësohet qytetarëve të Komunës tonë që përmes dhënies në shfrytëzim të hapin bizneseve të ndryshme investuese që mund të vijnë në Komunën tonë, të krijohen vende të lira pune për qytetarët tanë e që është edhe interes i Ekzekutivit që është tani, besoj ka qenë interes dhe i Ekzekutivit të kaluar dhe do të jetë interes edhe i Ekzekutivit të ardhshëm, kushdo qoftë ai.

Lista është e kompletuar, keni informacione të mjaftueshme për secilën nga këto parcela ku ndodhen dhe çfarë ndodhen, ju keni pasë mundësinë që edhe të hulumtoni listën e vitit të kaluar që është miratuar nga ky Kuvend e që në bazë të informatave që kam edhe LVV si opozitë në atë kohë e ka votuar, prandaj unë nuk shohë asnjë arsye që ky proces të prolongohet për arsye se është periudha ligjore kur kjo listë duhet të kalojë dhe nuk është mirë që qytetarëve të Komunës tonë t'iu privohet kjo e drejtë për të pasë mundësi dhe në dispozicion për marrje në shfrytëzim këto prona, në mënyrë që nesër ndonjëri prej tyre të jetë investitor potencial me mundësi të investimeve për zhvillimin ekonomik të Komunës tonë, por si do që të jetë ne jemi të prirë të respektojmë vendimin e shumicës që votojnë në Kuvend, sepse nuk kemi zgjidhje tjetër, mirëpo ju lus ta votoni sepse nuk do të ishte në rregull që në këtë çështje shumë pragmatike dhe shumë të rëndësishme për qytetarët tanë të del dikush kundër, mirëpo sërish e potencoj që sido që të jetë është çështje e juaja, ju mund ta bëni këtë, por pastaj mbetet që qytetarët ta vlerësojnë punën dhe angazhimin tuaj.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj që nëse nuk kalon sot ky propozim vendim, ne si Grup do të iniciojmë këtë çështje në Ministrinë e Pushtetit Lokal (MPL). Baza ligjore është provë dhe mendoj se kjo duhet të rikthehet në rishqyrtim në rast se sot nuk aprovohet ngase është një çështje ligjore e sqaruar shumë bukur dhe detajisht bindëse, besoj se duhet të jetë për të gjithë asamblistët, mirëpo siç thotë një fjalë, “ne mizat në krye nuk mund të ia heqim gjithkujt”.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, po e shohë se po bëhet një debat për të cilin nuk e kisha plan me dalë në foltore, mirëpo po e shohë një inat qysh nga fillimi për të mos ec puna mbarë, por që kjo çështje është në të mirë të qytetarëve. Ky është vendim që ka me iu jep komisionit dhe prapë ato prona kanë me kalu në Kuvend dhe të gjithë ne do të votojmë për miratim apo jo të tyre.

Unë nuk po e shohë ndonjë arsye përse mos me e mbështetë këtë propozim vendim, një gjë të tillë ne e kemi mbështet edhe vitin e kaluar, mirëpo këtu është një lloji inati që nuk ka ndonjë arsyetim. Kërkoj nga ju që ta votoni këtë pikë të rendit të ditës dhe unë si asambliste ju premtoj ashtu siç kam qenë në opozitë edhe tani në pozitë do të jem më e zëshmjja dhe më kritikja ndaj kësaj qeverisje për gabimet që mund ti ketë sepse vetëm me kritika mund të arrihet ndryshimi, kështu që edhe njëherë po ju ftoj të gjithëve që ta mendoni mirë këtë pikë të rendit të ditës dhe ta votoni.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, unë e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 11 vota janë për, 1 votë e përmbajtur, 21 vota kundër, nuk miratohet propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2021.

2. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB

z.Adnan Zymeri, theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, e mbështesim propozim vendimin për plotësimin e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB.

z.Vendenis Lahu, theksoi, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB me ndryshimet e fundit të procesit zgjedhor ka mbet pa dy anëtarë të Ekzekutivit të cilët kanë qenë të caktuar, andaj konsideroj se është obligim i yni që ta mbështesim plotësimin për të cilin emrat i përcakton Kryetari i Komunës në bazë të juridiksionit që e ka, prandaj nuk kemi se si të themi ndryshe as ne.

z.Fatmir Rudari theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahë këtë plotësim ndryshim të KKSB-së sipas materialit të dërguar.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se ta hedh në votim, dua të konstatoj se ka ndodhë një gabim teknik në hyrje të vendimit, konkretisht, “*në vend të vitit 2020 duhet të jetë 2018*”, andaj nëse miratohet tani, të korrigjohet ai gabim.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB sipas propozimit të dërguar me materialin e kësaj pike, korrigjimin e gabimit teknik të paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe me spastrimin e tekstit sipas vendimit bazë dhe plotësim ndryshimeve pasuese.

3. Propozimi i draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me draftin e Planit të punës së Kuvendit i cili është hartuar nga Grupi punues i ngritur nga Kuvendi i Komunës pjesë e të cilit kam qenë edhe unë. Është draft i unifikuar të cilin e kemi diskutuar edhe në KPF dhe e kemi sjellë para Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo e hedh në votim sipas materialit të dërguar dhe rekomanduar nga KPF.

Natyrisht që rendi i ditës ka mundësi të plotësohet dhe pasurohet edhe me pika tjera që rrjedhin nga Kryetari, Ekzekutivi dhe palët tjera, mirëpo si plan kemi këtë.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozimi i draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021, sipas materialit përkatës të dërguar dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së.

4. Të Ndryshme

z.Pajtim Hodolli, theksoi, zotëri Kryetar ju uroj pozitën e re që keni marrë dhe shpresoj se do ti realizoni premtimet që keni dhënë, fillimisht dua të potencoj që koha dhe kushtet klimatike kanë ndryshuar dhe është stinë dimri dhe temperaturat janë duke rënë dhe në këtë sallë ku jemi nuk po plotësohen kushtet. Në mbledhjen e radhës nëse nuk ka kushte për mbajtjen e mbledhjes unë personalisht nuk do të qëndroj në seancë sepse është shumë ftohtë, prandaj besoj se në seancën e radhës do të përmbushet kjo kërkesë.

Sot për pikën të ndryshme desha të diskutojë për dy pika që mendoj se janë shumë të rëndësishme duke parë gjendjen me të cilën ndodhemi nga pandemia covid-19, dhe duke parë se shumica e komunave kanë marrë një hap për ndarjen e të hollave për ndihmë për ata të cilët janë prekur nga ky virus, në këtë kontekst i propozoj Kryetarit të Komunës që në bazë të mundësive buxhetore t'ju ndihmoj personave të prekur me covid-19 në një afat sa më të shpejt që është e mundshme. E di që shumë komuna kanë marrë këtë vendim dhe kanë caktuar shuma të ndryshme mirëpo sa i përket shumës kisha dashur të diskutojë me Grupin e këshilltarëve komunal në një seancë të radhës.

Duke njohur Kryetarin si profesor nga universiteti dhe lëndët që ligjëron ai, besoj që e din një shqetësim që është duke ndodhë në mbarë vendin por me theks të veçantë në Kosovë rënia dhe nataliteti që është duke ndodhë me të madhe dhe duke u bazuar në shumë komuna të cilat po e stimulojnë këtë gjë e sidomos te çiftet e reja, po ashtu i propozoj Kryetarit të Komunës që kurdo që krijohet mundësia të ndajë një shumë të caktuar për nënat të cilat lindin, propozimi është që për çdo lindje të subvencionohen me nga 100€.

z.Agim Behluli, theksoi, përshëndetje për të gjithë e në veçanti për pushtetin e ri megjithëse është dashur të na prezantohen se kush janë pjesë e Ekzekutivit të ri, por në rregull do njihemi më vonë. Kam një propozim, me punimet në shesh, rrugët e qyteti janë bllokuar, andaj propozimi është që të rishqyrtohen rrugët që aktualisht përdoren vetëm në një kahje/drejtime dhe të bëhen dy kahëshe/drejtime, me theks këto dy rrugët në afërsi të objektit të Komunës – në pjesën e poshtme, propozim të cilin e kam pasë edhe më parë dhe pati hyrë në planifikime.

Shumica nga ju këtu jeni të ri, andaj ju lus të gjithëve sepse në vitet 1981 deri në vitin 1990, këtu te ne ka qenë formuar një grup për diferencimin ideo politik e që patën filluar me largimin e njerëzve nga puna, mirëpo të njëjtit njerëz në vitin 1990 pastaj patën lëshuar mjekrat, mustaqe dhe patën mbuluar fytirën me shalla dhe u fshiheshin, andaj kërkoj nga ju që mos ti largoni njerëzit nga puna, të gjithë ne po i shohim dhe e dimë situatën që e kemi, andaj të mos vie pastaj nesër puna që dikush ta mbulojë kokën e të fshihet. Me një thënie të mirë e keni marrë pushtetin, hairin ia pafshi.

Kjo është edhe një zgjarje për ne LDK-në sepse na patë zënë gjumi paksa dhe tani na keni zgjuar prej gjumi dhe ju falënderoj për këtë.

Kam pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, sepse LVV-ja çdo herë kërkonin informatë për bibliotekën, andaj pyetja ime është se kur do të fillojë ndërtimi i bibliotekës dhe ku, mirëpo asnjëherë ne nuk e kemi bërë një pyetje të cilën është dashur ta bëjë z.Bajram Ajeti dhe ne të tjerët për bibliotekën që ka qenë e ndërtuar në qytet, se ku ka mbet ai objekt, prandaj unë e bëra këtë pyetje edhe për objektin e ri se ku do ta ndërtoni dhe kur.

Kam edhe një pyetje tjetër që ka të bëjë me sigurinë, para tri ose katër dite vëllaun tim e kanë plagosur disa kriminel ndërsa para disa muajve na është grabitur një person/punëtor i “Interëksit” të cilit i’u kanë grabitur 30,000.00€, në mes të qytetit, andaj kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, çfarë ke ndërmarrë, të paktën a keni dalë para mediave me deklaruar se është sulmuar një biznes, është sulmuar një familje që e ka financuar 10 vite arsimin, kurse ju s’keni ndërmarrë asgjë. Sot këtu është dashur të jetë prezent edhe komandanti i Stacionit të

Policisë dhe të na tregoj se çka ka ndërmarrë ai mirëpo herën tjetër kisha pasë dëshirë të jetë prezent. Kam edhe plotë pyetje tjera por sot është hera e parë dhe thjesht po tërhiqem sepse e kam listën shumë gjatë ju kisha lutur pak ma me “metehirë” siç thotë populli, dhe me i marrë gjërat pak më ndryshe dhe me u marrë me sigurinë. Nuk e di a e dini ju që me ne është duke u marrë Fondi Monetar Ndërkombëtar se na u kanë thyer 20 banka për dy muaj në nivel të Kosovës, në qoftë se fillojnë bankat me u tërheq prej këtij vendi edhe ne së bashku me to duhet të ikim sepse askush nuk rri më me ne këtu. Po ashtu kam edhe pyetjen tjetër pak më të rëndë, që i ceku edhe Kryetari e që unë e përgëzoi që këto prona duhet me i dhënë me qira dikujt që vjen dhe investon, unë them jo Kryetar, këtu nuk vjen askush me investuar sepse ne jemi ardhë në atë gjendje me u larguar prej këtij vendi, jo vetëm në Komunën e Podujevës por në nivel të Kosovës nuk vjen askush të investoj sepse siguria është zero. Kur kriminelit del dhe i sulmon njerëzit në mes të qytetit dhe ka përkrahjen e policisë sonë, vetë policia janë deklaruar, ne çka me thënë kur na është sulmuar njeriu në mes të qytetit me 30,000.00€ me gjithë këto kamera të sigurisë, ju vet keni qenë ata që keni deklaruar se nuk na duhen këto kamera, tash i kemi kamerat e sigurisë dhe askush asgjë s’ka qenë në gjendje së paku një kërkim falje ta bëjë, kjo është tmerr mua nuk po më dhimbset vetja sepse ajo çështje ka kaluar ka kaluar mirëpo po më dhimbset këta djem të ri që kanë përfunduar studimet janë këtu dhe po mundohen të bëjnë diçka, kurse ne nuk po ju ndihmojmë asgjë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kam dy pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit z.Avni Fetahu, ju e dini se profesori i Edukatës Fizike në fshati Shajkoc ka ndërruar jetë, dhe a është e vërtetë se në fshatin Shajkoc respektivisht në fshatin Dumosh keni sistemuar një arsimtar të Edukatës Fizike, në qoftë se e keni sistemuar a është ky sistemim në pajtim me ligjin për zyrtarët publik i cili siç e dimë është në fuqi prej muajit korrik të këtij viti. Pyetja e radhës për ju zotëri Fetahu ka të bëjë me konkursin për mësimdhënës për lëndën teknologji informative në fshatin Batllavë, nëse nuk gaboj është anuluar ky konkurs. Referuar intervistës me shkrim del se kandidati që është përzgjedhë më vonë ka qenë në listë i katërti, referuar këtij ligji që sot është në fuqi testi me shkrim sot vlerësohet deri në 70 pikë, totali i pikëve është 100, 20 pikë i merr për shkak të performancës, trajnime, vlerësimit dhe 10 pikë janë nga intervistimi me gojë, andaj si është e mundur të shkelet në mënyrë kaq drastike kjo dispozitë e ligjit për zyrtarët publik.

Po ashtu drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies nuk qenka këtu, mirëpo i drejtohem Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi, drejtoria në fjalë ka shpallë konkurs për drejtor në QKMF dhe disa pozita tjera për punonjësit shëndetësorë ku edhe ky konkurs është shpallë në bazë të ligjit për zyrtarët publik. Sa për informacion tuajin zotëri Kryetar, Qeveria është duke e përgatitur aktin nënligjor respektivisht rregulloren për marrëdhënie të punës dhe ajo sot është në dëgjim publik. Deri sa kjo rregullore nuk është në fuqi ky konkurs i nderuar Kryetar është i kundërligjshëm.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, kur flenë goxha shumë e pastaj kur zgjohesh goxha shumë të vjen me fol, edhe sot pak apo shumë këtë gjendje po e shohë, ndoshta për temat e njëjta që asnjëherë nuk e keni ngritë zërin si pozitë që keni qenë dhe sot të gjitha këto që u përfshinë ndoshta janë të tepërta. Sa i përket z.Agim Behluli që tha për Bibliotekën, më duket se dy seancat e fundit kam dalë në foltore dhe kam thënë se si është e mundur që parashihni ndërtimin e bibliotekës me 50,000.00€, ju e keni votuar atë buxhet jo ne dhe tani nuk ke të drejtë me dalë dhe me i kërkuar sqarime drejtoreshës së DKRS-së se si ke me ndërtuar atë bibliotekë. Ne ndoshta ju kemi lodhë po ju kemi lodhë para miratimit të buxhetit, kështu që nuk është e drejtë me dalë në foltore dhe vetëm me kërku sqarime.

Nga drejtoria e Buxhetit dhe Financave nuk na u japë ndonjë informatë lidhur me buxhetin dhe unë kisha dashur një informatë të tillë nga drejtoria përkatëse pak a shumë me parë gjendjen financiare se deri ku ka shkuar kjo drejtori.

znj.Mimoza Sfishta Abdullahu, theksoi, unë kam një propozim për Ekzekutivin që të ketë parasysh ndërtimin minimum të dy çerdheve përmes bashkëpunimit publiko privat, pasi që në Komunën tonë është vetëm një çerdhe dhe nuk i plotëson kushtet minimale që fëmijët tonë të kenë aktivitete në atë çerdhe, kapaciteti i të cilës është shumë i vogël, tani a është e mundur të vazhdoj ky bashkëpunim me çerdhet private apo do të ndërtohen nga fillimi është çështje e Ekzekutivit që e merr këtë vendim, andaj ju lus që ta keni parasysh këtë propozim.

z.Bajram Ajeti, theksoi, më pëlqen gjithë ky aktivizim i gjithë asamblistëve posaçërisht i atyre që kanë fjetur që tri vite sepse gjithmonë kanë qenë në mbi peshë dhe i kanë ngritur duart duke thënë po po, për mua sinjerisht po e them është e mirëseardhur sepse këtu ka kreativitet këtu ka ide ka iniciativa, megjithatë më pëlqej një çështje që e ngriti z.Agim Behluli kur tha se çështja e sigurisë nuk është në nivel, madje pajtohem plotësisht kur e kërkoj që në seancën e ardhshme të thirret Komandanti i Stacionit të Policisë në Komunën e Podujevës dhe të raportojë lidhur me të gjitha çështjet për të cilat do të jemi edhe ne të interesuar t'i parashtrojmë para tij.

Çështje tjetër, mendoj se aktet nënligjore dhe ligjet kanë dallim normalisht që aktet nënligjore janë udhëzues për zbatimin e ligjit, përderisa nuk ka akte nënligjore është ligji i cili zbatohet kështu që kjo është një çështje shumë themelore dhe është diçka që duhet të dihet. Edhe një gjë po ua them, ju kuptoj në shpirt juve, edhe mjalte me ju dhënë tani ju duket e hidhur.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, Rregullorja e punës së kuvendit përcakton qartë se çfarë dhe pse mund të diskutohet dhe sa dhe si mund të paraqiten pyetje në pikën të ndryshme.

z.Agim Behluli, theksoi, një sqarim rreth bibliotekës, nuk thash të ndërtohet sot por vetëm pyeta ku dhe kur sepse kam qejf të ndërtohet, ndërsa se a kemi buxhet apo jo ato mjete i gjejmë dikund vetëm tregona ku dhe kur sepse nuk jam kundër bibliotekës. Unë e paraqita një pyetje pak më herët por si duket se paske kuptuar t'i (i drejtohet z.Bajram Ajeti), fjala ishte për bibliotekën që ka qenë në qendër, më intereson ta dijë se ku është sepse ajo pas një jave që kanë ikur forcat serbe dhe kanë ardhë forcat e KFOR-it, dikush e ka ndez, unë nuk e di kush ama dikush e ka ndez (i ka futur flakën) bibliotekës. A është djegur ish biblioteka z.Bajram Ajeti, sa për sqarim unë nuk ceka se kush e ka djegur por vetëm thash se ka qenë këtu por nuk është më, ndërsa ti në atë kohë ke qenë njëfarë lloj pushteti.

z.Pajtim Balaj, drejtor Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE, theksoi, kam qenë disa muaj këshilltar i Kuvendit këtu dhe pika më problematike për mua ka qenë pika, të ndryshme, sepse gjithmonë kam përgatitur pyetje dhe kur ka ardhur koha që ato pyetje t'i parashtroj asnjë prej drejtorëve nuk i kemi pasë prezent në sallë. Sot fatmirësisht na keni këtu dhe mund të bëni pyetje pa fund dhe ne brenda mundësive tona jemi të gatshëm t'iu përgjigjem. Çështjet dhe pyetjet që u ngritën për mu si drejtor i DPZHE, mendoj se më shumë janë në fushën e sigurisë.

Përndryshe për ekonominë jeni në dijeni se në çfarë gjendje e keni lënë buxhetin të cilin ju e keni votuar, jeni në dijeni për buxhetin e DPZHE, dhe jeni në dijeni që në sektorin e zhvillimit e keni vetëm një zyrtar i cili është shëf i zyrës, do të thotë, sektorin më të rëndësishëm e keni lënë vetëm me një punëtor, veç me një shëf i cili se ka asnjë punëtor. Sa i përket çështjes së vjedhjeve kjo mendoj se është jashtë kompetencave që kam unë, kurse në rrafshin personal më ka shqetësuar ajo çka ju ka ndodhë dhe kam kontaktuar me vëllaun tuaj Fatonin i nderuar Behluli, dhe të paktën këtë si qytetarë kam mundur ta bëjë dhe të shpreh një shqetësim.

z.Agim Behluli, theksoi, unë nuk pyeta për ekonominë e Komunës sepse e dimë atë, madje unë nuk e kam lënë në kurrfarë gjendje sepse nuk kam pasë kurrfarë funksioni përveç si anëtar i Kuvendit që jam, me 200€ rrogë/kompensim të cilat i kam harxhuar, mirëpo fjala ishte për ekonominë private të cilat ne po i'u kërkojmë taksa dhe po kërkojmë të jenë në rregull dhe po shkojmë e po i shqetësojmë,

çështje kjo që nuk është vetëm në komunën tonë por në tërë Kosovën sepse nuk është rasti të unë dhe nuk po më shqetëson rasti im aspak ngase unë jam mësuar me këto gjëra.

Në vitin 2000 unë jam ai Agimi që jam sulmuar në të gjitha anët dhe jam ai Agimi që kam qëndruar para kriminelëve dhe qëndroj prapë, dhe jam këtu t'iu dal ballë kriminelëve, në mendje nuk e kam të kërkoj ndihmë prej teje (*i drejtohet parafolësit*) dhe as prej askujt. Unë pyeta çka ke ndërmarr ti për rastin e “Intereksit”, a e ke bërë të paktën një prononcim, nuk po kërkoj ndihmë prej teje që të më mbrosh mua sepse unë e mbrohem vet, dhe nuk po kërkoj financim nga ti apo nga dikush tjetër sepse unë kam financat e mia dhe punën time, por po kërkoj siguri për këtë vend, për këta njerëz sepse këtë rini që po e shohë unë kanë me ikë prej vendi në qoftë se ne vazhdojmë kështu. Unë po i them Kryetarit dhe ty drejtor i DPZHE dhe të gjithë Kosovës se nuk e kam ndërmend të dalë nga ky vend dhe të dorëzohem para këtyre njerëzve sepse s’ju kam dorëzuar asnjëherë as atyre të tjerëve, e as juve dhe askujt tani. Unë po them ti si drejtor i DPZHE çka ke ndërmarr o zotëri, a keni dalë të paktën me një prononcim para gazetarëve sepse tu ka sulmuar punëtori i “Intereksit” dhe i janë marrë 30,000.00€ në mes të qytetit, a keni dalë para mediave, pyetje të cilën ia paraqesë edhe Kryetarit, nuk po ju them ejani e më mbron mua se skam nevojë sepse unë mbrohem vet, prandaj të merremi seriozisht me këtë punë sepse absolutisht s’ka çka të vyen ky vend në qoftë se t’i nuk mund të arrish të sigurosh asgjë. Vendi ynë u shndërrua si Brazili ku bankat sulmohen me dinamit dhe nuk e di a e keni pa apo nuk jeni duke jetuar këtu ku sulmohen bankat me dinamit në shekullin e XXI, në një vend ku kemi 10000 polic, andaj ju lutem mos bëni shaka sepse njerëzit janë duke ikë nga vendi, ndoshta një ditë edhe unë do të tërhiqem andaj mos t’i marrim gjërat personale.

Shumë të qartë e kam atë se çka jam duke fol, nuk jam duke fol përralla, andaj të mos kthehemi në vitin 2000 sepse kam shumë pyetje të rënda, madje aq të rënda sa që dikush duhet të dal nga ky takim, sepse e keni mbush këtë vend me krim.

z.Avni Islami, theksoi, jam para juve dhe vijë nga sektori i sigurisë, ju njoftoj se gjendja e sigurisë në vendin tonë është mjaftë e qetë, siguria e brendshme dhe e jashtme është jo në nivelin e duhur por e menaxhuar nga mekanizmat e sigurisë së bashku me ata ndërkombëtar. Bazuar në raportet e mëparshme të viteve të kaluara me këtë vit, vjedhjet, vrasjet, plaçkitjet etj, janë diku rreth 20% më pak, absolutisht se ka vend për kritika që të bëhet më mirë qoftë nga policia e Kosovës, qoftë mekanizmat tjerë të sigurisë por që të gjithë së bashku duhet të punojmë në këtë drejtim që nga qytetarët, ne si asamblistë, deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të gjithë së bashku të kontribuojmë për një klimë të qetë të sigurisë. Rastet e fundit që kanë ndodhur në Komunën e Podujevës që i përmendi kolegu z.Agim Behluli, plaçkitja e “Intereksit” etj, janë disa pjesë të qytetit që nuk janë të monitoruara nga kamerat e sigurisë së policisë, për fat të keq është rast i izoluar dhe policia është duke punuar në atë drejtim. Rastet e fundit që ishin plagosja e familjarëve të z.Agim Behluli është rast për shqetësim që duhet në të ardhmen Policia e Kosovës, Stacioni i Policisë në Podujevë t’i ngritë kapacitetet e tij dhe të punojë më tepër, por puna e secilit institucion varet edhe prej kapaciteteve, prej logjistikës dhe mjeteve që i ka. Fatmirësisht Stacioni i Policisë në Podujevë ka qenë nënstation i Policisë mirëpo para rreth dy muajve ka kaluar në Stacion të kategorisë A dhe ka mundësi që t’i rritë kapacitetet, por duhet kohë dhe veprim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, u ngrit çështja rreth sektorit të sigurisë por faktikisht Kryetari deri sot nuk ka mundur ta thërras mbledhjen e KKS-së sepse sot është bërë plotësim ndryshimi i KKS-së, ne do të përfillim rendin sepse po e shohë që po bërtasin këtu. z.Agim Behluli tha me dalë jashtë sallës, mirëpo askush nuk del jashtë sallës pse nervozohem unë shembull, ose pse kam probleme mirëpo ne duhet bashkërisht të zgjedhim problemet, është shqetësuese rasti që ka ndodhë.

Propozoj që në bazë të komunikimit që ka Kryetari i Komunës me Komandantin e Stacionit Policor në Podujevë, në bazë të rregullave të vije në Kuvend. Dy herë e kemi pasë prezent në Kuvend

Komandantin e Stacionit Policor në Podujevë mirëpo 98% e këshilltarëve të Kuvendit nuk e kanë parashtrua asnjë pyetje, por kanë ardhë në seancë për mëditje. Ne nëse dëshirojmë ta ndihmojmë sigurinë në vend ose Ekzekutivin e Komunës apo të mundohemi ta zgjedhim problemin që e ka z.Agim Behluli dhe të tjerët ngase vërtetë janë duke ndodhë dukuri negative, mirëpo për banka dhe për sigurinë në nivel të Kosovës ne nuk kemi kompetenca sepse nuk jemi të zgjedhur për ata, mirëpo kemi të drejtë të flasim këtu për Komunën e Podujevës dhe këtu do e japë kontributin tim si këshilltar i Kuvendit, aty ku kërkohet si në qeverisjen e kaluar dhe në këtë të tanishmen do të jem aty të jap ide dhe mbështetje edhe në të ardhmen. Ne është mirë të thërrasim Komandantin e Stacionit Policor në Podujevë kurdo që ai ka mundësi të vijë, qoftë në muajin janar apo shkurt, të përgatitemi edhe ne sepse pavarësisht kujt i ndodhin, këto raste, madje më të rënda na kanë ndodhë edhe neve sepse na kanë gjuajtur dhe plagosur, por nuk mund t'iu thuash kriminelë të gjithë policisë sepse po të mos ishte policia nuk do të kishte siguri këtu, andaj t'i lëmë këto paragjykime.

Fenomene të tilla nuk janë duke u zvogëluar siç e tha z.Avni Islami sepse t'i hyhet njeriut në shtëpi nuk është vetëm problem, mirëpo këtu Kryetari i Komunës është shërbyes civil dhe nuk ka revole dhe pranga ta prangos askënd. Prandaj e them që nëse vije në këtë Kuvend Komandanti i Stacionit në Podujevë të gjithë ne bashkërisht duhet të kontribuojmë në këtë aspekt qoftë me pyetje, propozime konkrete etj, sepse asnjëri nga këshilltarët këtu prezent nuk ka asnjë propozim se si të zhduket ky fenomen, si të zhduken aksidentet, për akset me fatalitet, siç është magjistralia Podujevë Prishtinë, mandej më konkret rruga në fshatin Llugë, Komuna nuk mund të vendos të ashtuquajtur polic të shtrirë ose shenja tjera sinjalizuese sepse Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për atë rrugë ku po ndodhin aksidente me fatalitet. Prandaj përgatituni për seancë, për akset me rrezikshmëri të lartë të vdekjes se si të eliminohen, për çështjet e sigurisë kërkoni të shtohen patrullat statike, kamerat e sigurisë sepse ne kemi pasë debate lidhur me kamerat e sigurisë se duhet të vendosen këtu ose aty.

Për fund ne po përgatitemi zotëri Kryetar pasi që është ky shqetësim dhe në bazë të mundësive të kërkohet një raport nga Komandanti i Stacionit të Policisë për të gjitha këto shqetësime që po ndodhin, nëse është e mundur nëse jo ne do të vazhdojmë në bazë të mundësive që i kemi.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, unë do t'i përgjigjem pyetjes së këshilltares znj.Doruntina Hasani e pati interesim lidhur me situatën buxhetore në të cilën ndodhet Komuna e Podujevës. Që nga dita e parë e qeverisjes kur kemi filluar ne rrjedhimisht me datën 9 dhjetor 2020, duke pasë parasysh se është fundi i vitit dhe duhet të përmbyllet pagesat për projektet që janë në proces nga zyrtarët e DBF-së, kemi kërkuar raportin financiar për mjetet e zotuar. Më datë 10.12.2020 mjetet buxhetore të cilat është dashur të shpenzohen vetëm nga granti qeveritar kanë qenë 3,730,150,60 €, përveç këtyre mjeteve janë edhe 238,616.00€ mjete këto të cilat me një vendim të Kuvendit të Komunës janë rialokuar në projekte tjera, mirëpo Ministria e Financave nuk i ka rialokuar këto mjete dhe rrjedhimisht nuk kemi mundur t'i zotojmë këto mjete për arsye se në bazë të procedurave nuk kanë mund të ndahen.

Kryesuesi i Kuvendit, kërkon nga drejtori i parafolës që t'i përgjigjet konkretisht pyetjes e jo të paraqitet informata totale sepse është pika të ndryshme.

Lëshohet mbledhja nga këshilltarët e Kuvendit nga radhët e LDK-së, PDK-së dhe disa të tjerë

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kërkon të konstatohet kuorumi, dhe shton, nëse nuk ka kuorum, siç edhe po vërehet, mbledhja nuk mund të vazhdoj dhe e konstatoj të mbyllur këtë mbledhje, por fillimisht të numërohen sa anëtarë janë prezent.

Konstatohet se në sallë prezent janë 12 këshilltarë të Kuvendit të Komunës.

z.Fatlum Osmani, drejtor i – DBF, përgjigje Kryesuesit të Kuvendit, pyetjes jam duke iu përgjigjur. Nga kategoria e pagave, si qeverisje e re komunale jemi angazhuar maksimalisht që nga dita e parë të përfundojnë punët dhe projektet e nisura në mënyrë që të ekzekutohen pagesat që kanë mbetur nga suficiti buxhetor, gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar 1,916,826.00€, ndërsa të pa shpenzuara mjete të cilat janë kthyer në thesarin e shtetit janë 2,052,940.60€. Sigurisht që arsyeja e mos shpenzimit të këtyre mjeteve dhe kthimi i tyre si suficid buxhetor është planifikimi i dobët i buxhetit të miratuar nga këta që dolën nga salla, planifikimi i dobët i planit të prokurimit që e kanë bërë ata që kanë shkuar më herët dhe mos fillimi me kohë i procedurave të prokurimit sepse siç duket e kanë lënë për fund vit për të bërë disa (allashvereshe) si zakonisht.

Këtë informatë të cilën e vlerësuam që ta prezantojmë para Kuvendit të Komunës në mënyrë që të informoheni rreth shpenzimeve dhe suficitit buxhetor dhe që gjithashtu bashkërisht të angazhohemi që gjatë vitit 2021 të mos e kemi këtë problematikë dhe që mjetet e parapara në buxhet të shfrytëzohen për të mirë të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, i nderuar drejtor, kur nuk ka kuorum mbledhja ndërpritet menjëherë, sepse kjo është e rregulluar me Rregulloren të punës së Kuvendit, dhe duhet të jenë prezent të paktën 18 këshilltarë.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, zotëri Kryesues paske ndryshuar sepse keni mbajtur këtu seancë vetëm me dy ose tre veta dhe s'keni pasë kuorum kështu që keni pritur derisa janë ardhë krejt.

Të ketë diskutime është e drejtë, ndërsa të votohet pa kuorum jo.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarim parafolëses, rastet që po i cek ti kanë të bëjnë me pauza jo me zhvillim të punimeve të Kuvendit, pauzat propozohen dhe pastaj miratohen ose jo nga anëtarët e Kuvendit.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit, mund të propozosh, por këshilltarët e Kuvendit nuk e miratojnë, prandaj ti s'po dinë as me udhëheq me mbledhje.

z.Vendenis Lahu, theksoi, ashtu siç e kam thënë për publikun përmes mjeteve të informimit para disa ditësh po e them dhe po e përsërisë sërish këtu që kjo është seanca ime e fundit në Kuvendin Komunal të Besianës (Podujevës). Arsyet që i kam cekur në publik vazhdojnë të jenë po të njëjtat pra për shkak të emërimit të Nënkryetares së Komunës, edhe pse e kam parasysh që nuk ka kurrfarë konflikti të interesit dhe as nuk bie ndesh në parimet etike morale, por megjithatë unë kam konstatuar se është vendim i drejtë që unë të tërhiqem nga asambleja komunale. Po e përsërisë sërish kjo është seanca ime e fundit dhe nga mbledhja e ardhme nuk do të jem pjesë e këtij Kuvendi. Kryetarit të ri të zgjedhur të Komunës i uroj punë të mbarë, punët do të jenë të shumta por besoj se do të ia dal me sukses ashtu siç besoj në Ekzekutivin e ri të Komunës që do të arrij t'i përmbush synimet të cilat ia ka caktuar vetës. Nuk kam asnjë fije dyshimi se ata edhe dinë dhe munden t'i arrijnë ato pikësynime, kolegëve të mi të deritanishëm të asamblesë i urojë punë të mbarë po ashtu edhe suksese. Opozitës së re i urojë punë të mbarë dhe njëkohësisht i kërkojë që të jenë kritik të kontribuojnë përmes këshillave dhe kritikës konstruktive sepse kritika është bazë e progresit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në emër timin personal të përshëndes dhe të uroj shëndet e suksese dhe të gjitha të mirat për bashkëpunim dhe kontribut duke i dëshiruar gjitha të mirat në jetë.

z.Florent Hasani, theksoi, dëshiroj të theksoj se qenka mbajtur një mbledhje me farmacistët dhe disa paskan kërkuar ndryshimin e orarit të punës por tani gjatë seancës më kanë ardhur disa mesazhe nga pronarët e barnatoreve që kërkojnë që ky orar mos të ndryshohet, thjesht u ndjeva i obliguar me paraqit këtë shqetësim. Është mirë edhe një herë prej fillimit të rishikohet vendimi sa i takon DPZHE-së.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht dëshiroj të bëjë një pyetje nëse kjo seancë monitorohet nga Ministria e Pushtetit Lokal apo jo. Gjithashtu kërkoj nga procesmbajtësit të mbahet evidencë rreth formës dhe mënyrës se qysh është duke u udhëheqë seanca.

Kryesuesi i Kuvendit nuk ka të drejtë të imponoj gjëra, seanca është në vazhdimësi, një pjesë e këshilltarëve dolën nga seanca, qëllimi i daljes po duket, mirëpo Kryesuesi nuk është ai që e din se kthehen apo nuk kthehen ata sërish, prandaj nuk është e drejtë e tij që të tentojë ta ndërpres seancën, por e drejtë e tij është që deri në asamblistin e fundit ta vazhdojë seancën, prandaj ju lutem keni vëmendjen dhe kujdesin qysh po menaxhoni me seancë. Në qoftë se je Kryesuesi i Kuvendit nuk je ti ai që cakton se si duhet të punohet brenda seancës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim dhe rikujtim të Kryetarit, unë jam ai Kryesuesi i Kuvendit që e kryesoj seancën në bazë të kompetencave sipas ligjeve dhe rregullave përkatëse në fuqi.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, përgjigje Kryetarit të Komunës, theksoi, nxirreni Rregulloren, gjejeni dhe lexoje se ku thuhet, në cilin nen në cilën pikë thuhet ajo që ju e thoni dhe veproni, prandaj mos dezinformo me opinionin por udhëheq me seancën ashtu siç duhet dhe sipas rregullave.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje Kryetarit, është çështje e qartë se si veprohet në rastet kur nuk ka kuorum.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit, ma thuaj se si parashihet dhe ku thuhet në rregullore se çfarë bëhet kur nuk ka kuorum, jo çfarë thua ti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, çdo herë duhet të verifikohet kuorumi, ka apo nuk, madje edhe pas çdo pauze.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, mua po më vie shumë keq që disa prej këshilltarëve që parashtruan pyetje nuk qëndruan në mbledhje për të marrë përgjigjet dhe kjo tregon edhe për përgjegjësinë e atyre këshilltarëve dhe cilat janë përgjegjësitë e tyre ndaj qytetarëve.

Po filloj me propozimin e z.Pajtim Hodollit që ishte një propozim shumë me vend çështja e mundësisë së ndihmës për qytetarët që janë të prekur me covid-19. Ne si Ekzekutiv i Komunës, të jeni shumë të bindur se kemi qenë shumë të interesuar për t'iu ndihmuar atyre qytetarëve dhe familjeve të tyre por ta keni parasysh se ish Ekzekutivi që ka qenë deri në marrjen e mandatit nga ne, ka lënë rreth 4 milion euro buxhet të pambuluar dhe në rrezik permanent që ai buxhet të shkoj si suficit. Për arsye të "përgjegjësisë të shkallës së lartë që e ka pasë" në raport me qytetarin, ju si Kuvend i Komunës keni mund të merrni vendim qysh më përpara që atyre personave të prekur me covid-19 t'ju ndahet shumë financiare, cila do qoftë ajo shumë. Lëvizja Vetëvendosje sigurisht që nuk e ka penguar një proces të tillë, por ju keni qenë ata që është dashur ta merrni një vendim të tillë, madje po edhe sot ju si Kuvend jeni ata që merrni një vendim të tillë kurse Kryetari i Komunës pastaj bënë shpërndarjen e mjeteve, mirëpo nuk mjafton vetëm të bëhen kërkesa nga këshilltarët dhe të iket pastaj (të lëshohet seanca) dhe mos të merren përgjigjet sepse është papërgjegjësi.

Ne në planin tonë të punës kemi paraparë që lehonave t'ju jepet një shumë e caktuar e mjeteve financiare, por ne nuk jemi ata që i marrim këto vendime, ky Kuvend duhet t'i merr ato vendime, urdhëroni sjellëni ato vendime në Kuvend dhe miratoni, pastaj ne do t'i respektojmë ato vendime sepse jemi të obliguar.

Rasti i asamblistit z.Agim Behluli, neve na vie shumë keq që ka ndodhur, dhe në emër tim si Kryetar i Komunës atyre që janë të lënduar ju shprehë shërim sa më të shpejtë duke uruar që sa më shpejtë t'i tejkalojnë ato probleme nga ai konflikt të armatosur që ka ndodhë dhe sigurisht që jemi shumë të brengosur për çdo shkallë të siguri që ndodhë brenda për brenda territorit të Komunës tonë dhe për qytetarët tanë sepse jemi të interesuar denjësisht që niveli i siguri që jetë në shkallën më të lartë.

Na vie keq që në këtë përfundim vit, të dalin me kërkesa ata këshilltarë të cilët tani kanë hyrë në vitin e katërt që janë këtu në Kuvend të Komunë dhe asnjëherë nuk e kanë ngritë shqetësimin të cilin sot e ngrisin, madje mund ta merrni me mend se sot kërkohet të bëhen dy linja/kahje të dy rrugëve, kurse ka mbi 3 vite që janë pjesë e këtij Kuvendi këtu dhe kanë fjetur në këtë Kuvend, kurse sot po kërkojnë me i ndërruar trasetë e rrugëve, thua që ne që kemi ardh në pushtet para 10 - 15 dite kemi ardhë me shkop magjik dhe do t'ua zgjidhin problemet 20 vjeçare që i kanë krijuar në Komunën e Podujevës. Këta e dinë shumë mirë se ajo punë nuk bëhet, mirëpo një fjalë e popullit thotë se (gjuha është prej tuli kah të ia japësh shkon) prandaj këta po i plotësojnë disa dëshira të tilla.

Sa i përket çështjes së Bibliotekës, ky Kuvend e ka miratuar një buxhet dhe dihet sa është shuma e destinuar për Bibliotekë prandaj të më bëhet pyetja mua dhe drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për objekt të Bibliotekës kjo është më shumë se qesharake.

Sa i përket sigurisë, jeni në dijeni që disa ditë para zgjedhjeve është ndërruar Komandanti i Stacionit Policor në Podujevë dhe atë Komandant e kanë sjellë për ma mirë këtu dhe ne presim që puna të ec më mirë, sigurisht se ne si institucione komunale do të ia japim gjithë ndihmën dhe mundësinë që ai ta bëjë punën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe do ta ketë përkrahjen tonë, mirëpo çështja e sigurisë nuk lidhet drejtpërsëdrejti me ne si institucion i Komunës sepse janë organet kompetente të cilat merren, sigurisht se shqetësimi për siguri është shqetësim edhe i yni dhe do të bëjmë çmos t'i dalim në ndihmë Komandantit të Stacionit të Policisë varësisht mundësive që mund të ndihmojmë si institucione lokale që jemi.

Si anëtar të Kuvendit të Komunës që jeni është mirë të shihni dhe të kërkonit përgjegjësi për ato shuma të mëdha për montimin e kamerave të sigurisë në qytetin e Podujevës ku me qindra mijëra euro janë shpenzuar por që janë funksionale ato kamera, kush i ka shkëputur nga funksioni ato kamera është mirë që ju si asamblast ta bëni këtë pyetje dhe të shikoni sepse është dhënë buxhet i qytetarëve, është derdhur para e qytetarëve për ato kamera, kurse sot nuk funksionojnë, prandaj është mirë të marrim përgjigje.

Dikush nga anëtarët e Kuvendit e përmendi Ligjin për zyrtarët publik dhe tha se duhet të pritët deri sa Qeveria të nxjerrë edhe Rregulloret, mirëpo ai po harron se Qeveri nuk ka sepse ka rënë realisht dhe ne nuk kemi kohë të presim derisa të bëhen Qeveritë, natën e ditën, por ne do t'i vazhdojmë punët dhe proceset tona dhe do t'i shtyjmë gjërat përpara me ato rregullore të cilat janë në fuqi, ndërsa kurdo që nxjerrën rregulloret e reja, pastaj i rregullojmë, i plotësojmë, i ndryshojmë dhe punojmë ashtu siç duhet sipas tyre.

Asamblast ja znj.Mimoza Abdullahu kërkoj edhe dy çerdhe publike, mirëpo nuk e di se a e ka ngritë zërin e përmendura kur është miratuar buxheti, konkretisht a ka kërkuar ndarje të buxhetit për një gjë të tillë, e them këtë sepse ato çerdhe (unë prej xhepit nuk mund t'i bëjë) por duhet të ndahet dhe të planifikohet buxheti, kurse ju jeni ata që e keni miratuar buxhetin, jo unë, por unë po e trashëgoj atë buxhet dhe duhet të punojmë sipas atyre kornizave që janë krijuar.

Lidhur me atë që këshilltari z.Rafet Llapashtica e përmendi rreth KKSb-në, sigurisht se unë do ta thërras takimin e parë sepse deri më tani zyrtarisht nuk e kam pasë këtë kompetencë, sot mora miratimin nga ana juaj dhe sigurisht që ditëve në vijim do të mbaj mbledhje me gjithë anëtarët e KKSb-së dhe do të diskutojmë edhe çështjen e sigurisë në nivel Komune.

z.Avni Fetahu, drejtor DKA, theksoi, zotëri Kryesues i Kuvendit ne po i japim përgjigjet sepse është obligim ligjor dhe ne duhet të jemi korrekt. Sa për sqarimin e juaj kuorumi është vetëm kur është në pyetje çështja për me marrë vendime, ndërsa në këtë situatë ata kanë parashtruar pyetje kurse ne e kemi obligim me kthye përgjigje.

Rastin të cilin e cekti shefi i këshilltarëve të LDK-së, ajo pikë është kthyer në pikën zero nuk është dërguar atje dhe nuk është duke punuar askush në shkollat të cilat ai i potencoj, të njëjtën kohë ato

komisione që e kanë prurë deri në atë pikë gjendjen e caktuar edhe për rastin në fshatrat Batllavë dhe Shajkoc, pikërisht janë komisione që janë ngritë nga ish Kryetari, kështu që ata kanë vepruar me të. Çfarë kemi mundur ne të realizojmë, ka qenë kthimi në pikën zero, përndryshe ju lus që ta evidentoni në procesverbal që përkundër vullnetit të drejtorit t'ju jap përgjigjen, shefi i Grupit të asamblistëve nga radhët e LDK-së që parashtrroi pyetjen nuk është prezent këtu. Në të njëjtën kohë ju lus ta evidentoni edhe elementin që kur u propozua prej asamblistëve një çështje për tu hedh në votim, nga Kryesuesi i Kuvendit nuk u lejua që ai propozim të hedhet në votim, kjo është me rëndësi dhe ne duhet t'i adresohemi Ministrisë së Pushtetit Lokal për këtë çështje. Propozimet që janë hedh në votim nga asamblistët nuk janë lejuar të votohen.

znj.Elhame Kutillovci, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, po më vie keq për kolegun i cili më parë orientoi pyetjen nga DKRS, madje në fakt duhet të thuhet drejtori e Kulturës Rinisë dhe Sportit, e jo “drejtoreshë e Muzikës” sepse i përfshin të gjitha artet.

I nderuar Kryesues, po besoj që ndokush nga të pranishmit këtu do t'ia përcjell përgjigjet asamblistit në fjalë i cili në fakt e ceku më herët se na keni zgjuar prej gjumi, është e vërtetë se i kemi zgjuar prej gjumi për shkak se edhe DKRS për disa vite ishte në gjumë, ka fjetur Komuna e Podujevës sa i përket këtij sektori e mos të flas për sektorët dhe Drejtoritë tjera, mirëpo po flas për punën time që kam parë gjatë këtyre ditëve. Bashkërisht me drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ne kemi parë buxhetin i cili është paraparë për Bibliotekës për të cilën ishte një buxhet shumë shumë i vogël 50,000.00€, shumë e cila është ndarë për renovim, jo për objekt të ri të Bibliotekës.

Së bashku me drejtorët e Drejtorive tjera do ta caktojmë ambientin ose vendin se ku duhet të bëhet renovimi i Bibliotekës. Faktikisht ajo shumë është dashur të jetë më shumë për gjëra ose për tituj të ndryshëm që i mungojnë Bibliotekës, krejt çka kemi mundur të bëjmë si qeverisje e re për këtë fillim së pari kemi krijuar kushte për ngrohje në sallën e leximit sepse ka pasë ankesa të vazhdueshme nga ana e lexuesve si dhe e kemi zgjatur orarin e leximit ku edhe këtë ua kemi mundur sepse mendoj se ka qenë një vendim shumë i pa arsyeshëm që Biblioteka të mbyllet në ora 16:00. Lexuesit nuk i përkasin çështjes administrative në fakt ata udhetojnë, shkojnë në fakultet në Prishtinë dhe pasditen e shfrytëzojnë për lexim, kështu çdo ditë të javës nga ora 8:00 deri në orën 23:00, ata mund të vijnë në sallën e leximit dhe të lexojnë.

Kryesuesi i Kuvendit, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/01-0079692/20
Podujevë,
30 dhjetor 2020

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi